



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/Xh1-20 Prot.

Tiranë 20/12/2024

Nr. Dok. 202300027/20

Lënda: *Rekomandim për trajtimin e rastit të shtetasit Xh.T*

**Drejtuar: AGJENCISË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE
pranë MINISTRISË SË MBROJTJES**

Tiranë

Për dijeni: PREFEKTIT TE QARKUT KORÇË

Korçë

Z. Xh.T

Pogradec

Të nderuar,

Sikurse jeni vënë në dijeni nga korrespondenca jonë zyrtare, pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë z. Xh.T. Nëpërmjet kësaj ankese ky shtetas shpreh shqetësimin e tij lidhur me zvarritjen e procedurave të akordimit të ndihmës shtetërore, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, pranë Ministrisë së Mbrojtjes (AKMC). Sikundër shkruan ankuesi, ai është banues në fshatin Velçan, Njësia Administrative Velçan, Pogradec. Në vitin 2010, banesa e tij është dëmtuar nga rrëshqitja masive e tokës në fshatin e tij. Nga ana e punonjësve të Komunës Velçan është bërë vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në banesën e tij, e cila është përlllogaritur në vlerën prej 563,830 lekë. Nga kjo shumë ai ka marrë vetëm 100,000 lekë, ndërsa pjesa tjetër rezulton e pashlyer deri më sot. Ankuesi pretendon se edhe pse ka kaluar çdo afat ligjor, ai nuk është dëmshpërblyer ende plotësisht, pavarësisht se është ankuar pranë AKMC-së, lidhur me këtë problematikë.

Gjendur para kësaj situate, ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje dhe zgjidhjen e këtij problemi, me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të tij të ligjshme.

Pas rregjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore të formës dhe të përmbajtjes për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, respektivisht nenet 13, 17 shkronja "a" dhe 18 shkronja "b", ka vendosur ta pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

-I-

Qëndrimi i Këshillit të Qarkut Korçë, Prefektit të Qarkut Korçë dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, lidhur me rastin .

1. Për shqyrtimin me objektivitet të kësaj çështjeje dhe për të mundësuar një hetim të plotë administrativ, në vështtrim të nenit 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *"Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentat dhe informacionet e kërkuara prej tij*, si dhe në nenin 19, gërma "b" të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit" të ndryshuar, në të cilin parashikohet se : *"Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin"*, me tonën nr. K3/Xh1-2 prot., datë 30.01.2023, *"kërkesë për shpjegime"*, i kemi kërkuar Bashkisë Pogradec dhe Njesisë Administrative Velçan, dhënien e shpjegimeve dhe të informacionit nëse qëndrojnë pretendimet e ankuesit si dhe mundësinë e zgjidhjes së problematikave të tij.
2. Me shkresën nr. 14/1 prot., datë 20.02.2023, Njësia Administrative Velçan, Bashkia Pogradec, në përgjigje të shkresës sonë na ka informuar se, dokumentacioni i banesave të dëmtuara nga rrëshqitjet e dheut të vitit 2010, për personin z. Xh.T dhe për persona të tjerë është dorëzuar pranë Këshillit të Qarkut Korçë, bashkë me vendimet e Këshillit të ish Komunës Velçan si dhe vendimet e Këshillit janë dërguar pranë Arkivës Pogradec.
3. Në vijim të hetimit administrativ me qëllim të zgjidhjes sa më të drejtë të kësaj çështjeje, me shkresën nr. K3/Xh1-5 prot., datë 24.05.2023, kemi kërkuar shpjegime pranë Këshillit të Qarkut Korçë.
4. Me shkresën nr. 347/1 prot., datë 31.05.2023, Këshilli i Qarkut Korçë, në përgjigje të shkresës sonë na ka informuar ndër të tjera se, për rastin e dëmtimit të banesës për shkak të rrëshqitjes së dheut të shtetasit Xh.T banues në Velçan, Njësia Administrative Velçan, Pogradec, Institucioni i Këshillit të Qarkut Korçë ka kryer të gjitha procedurat ligjore në zbatim të ligjit

nr. 8758, datë 26.03.2001, “Për Emergjencat Civile” dhe VKM-së nr. 206, datë 26.03.1998, “Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në rast fatkeqësish”, (VKM nr.206/1998), i cili ka qenë në fuqi në atë kohë. Ndërsa lidhur me informacionin e kërkuar nga ana jonë ka bërë me dije se, detyrat dhe kompetencat e Këshillit të Qarkut Korçë kanë qenë administrimi i dokumentacionit të përcjellë dhe vlerësimi i dëmeve të shkaktuara sipas dokumentacionit të administruar, për të vijuar me përcjelljen e dosjes pranë Prefektit të Qarkut Korçë. Më tej ka sqaruar se, nga dokumentat e administruar në arkivin e Këshillit të Qarkut Korçë, vlera e përlogaritur e dëmshpërblimit është 563,830 lekë. Sipas procedurës të parashikuar nga VKM nr. 206/1998, Këshilli i Qarkut Korçë me shkresën nr. 2335 prot., datë 6.12.2010, ka përcjellë dokumentacionin përkatës pranë Prefektit të Qarkut Korçë.

Bashkëlidhur shkresës së mësipërme Këshilli i Qarkut Korçë, ka dërguar të gjithë aktet që disponojnë për rastin në fjalë si më poshtë vijon:

- shkresë “Për dërgimin e dokumentacionit të emergjencës” nr.2335 prot., datë 16.12.2010, Prefektit të Qarkut Korçë;
- vendim nr. 41, datë 07.12.2010, të Këshillit të Komunës Velçan;
- relacion “Mbi dëmtimin nga rrëshqitjet e tokës të banesës së tokës në banesat e banorëve në Komunën Velçan, Qarku Korçë, datë 14.12.2010;
- vendim nr. 42, datë 07.12.2010, të Këshillit të Komunës Velçan;
- lista emërore e familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore;
- relacion “Mbi dëmtimin nga rrëshqitjet e tokës në banesat e banorëve në fshatin Velçan, të Komunës Velçan, Qarku Korçë, datë 14.12.2010;
- preventiv i Komisionit të Ekspertëve të Këshillit të Qarkut dhe planimetria përkatëse e banesës së shtetasit Xh.T.
- vërtetim datë 20.10.2010, i Zyrës së Gjendjes Civile të Komunës Velçan;
- proces-verbal datë 05.10.2010, i Komisionit të Emergjencave të Komunës Velçan;
- certifikatë familjare;

5. Në rrethanat sa sipër cituar, në vijim të hetimit administrativ të rastit, me tonën nr. K3/Xh1-7 prot., datë 10.07.2023, kemi kërkuar nga Prefekti i Qarkut Korçë të na informojë në lidhje me vazhdimin e mëtejshëm të procedurave, pas përcjelljes së dokumentacionit përkatës nga ana e Këshillit të Qarkut Korçë, pranë këtij institucioni, në lidhje me rastin e ankuesit Xh.T, si dhe nëse janë në dijeni të faktit nëse kjo shumë është akorduar pjesërisht apo tërësisht në favor të ankuesit.
6. Me shkresën nr. 606/1 prot., datë 19.07.2023, Prefekti i Qarkut Korçë, në përgjigje të shkresës sonë me nr. K3/M14-7 prot, datë 10.07.2023, me objekt: “*kërkesë për informacion*”, lidhur me ankesën e shtetasit Xh.T, ka shpjeguar ndër të tjera se, bazuar VKM nr. 206/1998, institucioni i Prefektit **ka dërguar dokumentacionin e përgatitur nga ana e ish Komunës Velçan dhe Këshilli i Qarkut Korçë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile (sot AKMC), për dëmet e shkaktuara nga rrëshqitja masive e tokës në fshatin Laktesh e Velçan.**

- 6.1. Nga shkresa nr.extra prot., datë 14.06.2013, *“Njoftim për dhënie fondi financiar njësave të qeverisjes vendore, për tu shpërndarë në ndihmë të familjeve me banesa të dëmtuara nga fatkeqësi të ndryshme”*, që Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile i ka drejtuar Prefektit të Qarkut Korçë, rezulton se në të janë përfshirë disa familje që kanë pësuar fatkeqësi të ndryshme dhe që nuk janë dëmshpërblyer, listë në të cilën ndodhet edhe emri i z. Xh.T, me vlerë 100, 000 lekë.
- 6.2. Në zbatim të shkresës së mësipërme, Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 618/4 prot., datë 17.06.2013, ka njoftuar ish-Kryetarin e Komunës Velçan, për bashkëpunimin dhe zbatimin e procedurave për tërheqjen e këtij fondi nëpërmjet Degës së Thesarit Pogradec, në të cilën ndodhet edhe familja e z. Xh.T.
- 6.3. Në këtë kuadër, ish Kryetari i Komunës Velçan, i është drejtuar Prefektit të Qarkut Korçë me shkresën nr. 60 prot., datë 11.10.2013, me të cilën ka kërkuar dhënien e ndihmës financiare për 28 familje në fshatin Velçan dhe 12 familje në fshatin Laktesh, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga shkarja e tokës në vitin 2010 dhe që nuk ishin trajtuar me ndihmë financiare, pjesë e kësaj liste ishte edhe familja e z. Xh.T, e cila rezultonte e trajtuar më parë në masën vetëm 100 000 lekë dhe jo në vlerën përfundimtare të përcaktuar për këtë familje.
- 6.4. Për zgjidhjen e këtij problemi në vijim Prefekti i Qarkut Korçë, me shkresën nr. 928/1prot., datë 28.10.2013, *“Kujtesë për çelje fondi për familjet e dëmtuara në Komunën Velçan të Rrethit Pogradec, si pasojë e shkarjes masive të tokës”*, i ka kërkuar ish-Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, mundësinë e çeljes së fondit financiar për këto familje.
- 6.5. Në mbështetje të kësaj situate, në shkresën nr. 3585/15 prot., datë 12.11.2013, që Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, i ka drejtuar Prefektit të Qarkut Korçë, theksohet se, *Drejtorja e Përgjithshme e Emergjencave Civile disponon dokumentacionin për dëmtimin e 46 banesave në fshatrat Velçan dhe Laktesh, si dhe njofton mundësinë për dhënien e ndihmës financiare të këtyre familjeve.*
- 6.6. Sa sipër, Prefekti i Qarkut Korçë ka sqaruar se, dosjet e këtyre familjeve dhe të personit konkret shtetasit Xh.T, janë transferuar në AKMC për trajtimin e tyre dhe Institucioni i Prefektit nuk disponon informacion të mëtejshëm mbi trajtimin financiar, në rastin konkret edhe për z. Xh.T. Bashkëlidhur kësaj shkrese ka dërguar kopje të akteve të sipërcituara, konkretisht:
- shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile *“Njoftim për dhënie fondi financiar njësave të qeverisjes vendore për tu shpërndarë në ndihmë të familjeve me banesa të dëmtuara nga fatkeqësi të ndryshme nr. extra prot., datë 14.06.2013;*
 - shkresë e Prefektit të Qarkut Korçë *“Njoftim për dhënie fondi financiar shtesë për tu shpërndarë në ndihmë të familjeve të dëmtuara nga fatkeqësi të ndryshme” nr. 618/1 prot., datë 17.06.2013;*
 - shkresë e Komunës Velçan nr. 60 prot., datë 11.10.2013;

- shkresë e Prefektit të Qarkut Korçë “Kujtesë për çelje fondi për familjet e dëmtuara në Komunën Velçan të Rrethit Pogradec, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, nr. 928/1 prot., datë 28.10.2013;
- kthim përgjigje nr. 3585/1 prot., datë 11.04.2013, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme.

7. Në kushtet e mësipërme i jemi drejtuar sërish me shkresën nr. K3/Xh1-9 prot., datë 24.07.2023, me objekt: “kërkesë për informacion”, AKMC-së, së cilës i kemi kërkuar të na informojë në lidhje me vazhdimin e mëtejshëm të procedurave pas përcjelljes së dokumentacionit përkatës zyrtar nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, si dhe veprimet e ndërmara pas dërgimit të shkresës nr. 928/1 prot, datë 28.10.2013, pranë DPEC, Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me akordimin e fondeve për dëmshpërblim përsa i takon rastit në fjalë.
8. Me shkresën nr. 1374/2 prot., datë 01.08.2023, AKMC ka shpjeguar ndër të tjera se, në kuadrin e akordimit të ndihmës financiare për banesat e shtetasve të dëmtuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, bazuar VKM nr. 206/1998 pas kontrolleve të realizuara ka konstatuar se rasti në fjalë nuk përfshihet në listën e shtetasve të cilët përfaqësojnë detyrimet e prapambetura financiare dhe me qëllim zgjidhjen e problematikës së përcjellë nga ana juaj jemi në vijim të procesit të inventarizimit sipas urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile nr.175, datë 29.07.2022 “Për sistemin e praktikave të kompesimit nga fatkeqësitë”, në fund të së cilës do ju informojmë në detaje mbi gjetjet dhe marrjen e masave të ndërmara referuar rastit në fjalë, pasi elementët e dokumentacionit tekniko-ligjor të shtetasit Xh.T nuk janë të sakta dhe të plota.
9. Në kushtet kur edhe pse kishte kaluar një afat i arsyeshëm kohor dhe nga ana juaj nuk jemi informuar lidhur me vijimin e ndjekjes së rastit në fjalë, ashtu sikurse kishte relatuar në shkresën e mësipërme, i jemi ridrejtuar me shkresën nr. K3/Xh1-11 prot., datë 20.11.2023, AKMC-së, të cilës i kemi kërkuar të na informojë lidhur me pyetjet e parashtruara sa më poshtë vijon:
 1. Përgjatë kësaj kohe a ka përfunduar procesi i inventarizimit sikurse keni parashtruar sa sipër?
 2. Nëse po cilat janë gjetjet lidhur me rastin?
 3. Çfarë masash keni ndërmarrë lidhur me akordimin e ndihmës financiare për pjesën e pashlyer të detyrimit deri më sot për shtetasin Xh.T, banesa e të cilit është dëmtuar si pasojë e rrëshqitjes masive të tokës në vitin 2010?
 4. Si e shpjegoni faktin e pretenduar nga ana juaj për mungesë të dokumentacionit për këtë shtetas ndërkohë që atij i është akorduar më parë pjesërisht një shumë në masën prej 100000 lekë për kompesimin financiar?
- 9.1. Me shkresën nr. 2010 /2 prot, datë 04.12.2023, që AKMC i ka drejtuar Bashkisë Pogradec, (për dijeni) Avokatit të Popullit, ka bërë me dije se, AKMC-ja nën kuadrin e akordimit të ndihmës financiare për banesat e shtetasve të dëmtuar nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore dhe bazuar në VKM nr. 206/1998, pas kontrolleve të vazhdueshme arkivore dhe realizimit të procesit inventarizues, nuk disponon të plotë dhe të

saktë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga ish komuna Velçan për rastin e shtetasit Xh.T. Në mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe pas kontrolleve të vazhdueshme për administrimin e rastit në fjalë, ka rezultuar se shtetasi nuk përfshihet në listën e shtetasve të cilët përfaqësojnë detyrimet e prapambetura financiare dhe si rrjedhojë AKMC nuk përmban detyrim financiar për rastin e pretenduar. Procedura administrative e çeljes së fondit financiar për dhënien e ndihmës financiare realizohet në momentin kur disponohet dokumentacioni tekniko-ligjor i saktë dhe i plotë, bazuar dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi. Për të respektuar procedurat dhe dispozitat ligjore vepruese, realizimi i shpërblimit të dëmit të shkaktuar ankuesit, kërkon dokumentacione në përbërje të së cilës elementët janë të saktë dhe të plotë. Në vijim AKMC shprehet se me qëllim orientimin e zgjidhjes së rastit ka kërkuar nga Bashkia Pogradec vënien në dispozicion të dokumentacionit tekniko-ligjor të shtetasit Xh.T. Kjo pasi referuar nenit 22, pika 1, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, janë arkivat shtetërore vendor që administrojnë dokumentet e trashëguara si dhe dokumentet e Arkivave të institucioneve shtetërore vendore dhe të organeve të qeverisjes vendore që veprojnë brenda njësisë administrative-territoriale përkatëse.

10. Në analizë sa sipër, kemi konstatuar se pavarësisht përgjigjes së dërguar nga ana juaj në thelb nuk kemi marrë përgjigje lidhur me Tonën nr. K3/Xh1-11 prot., datë 20.11.2023, prandaj me shkresën nr. K3/Xh1-13 prot., datë 01.02.2024, ju kemi rikërkuar të jepni qëndrimin duke i dhënë përgjigje në mënyrë eksplicite secilës prej pyetjeve të parashtruar nga ana jonë, të cilat i kemi konsideruar të rëndësishme në kuadër të planit të hetimit. *(bashkëlidhur ju kemi dërguar kopje të dokumentacionit përkatës lidhur me rastin të dërguar nga ana e Këshillit të Qarkut Korçë si dhe nga Prefekti i Qarkut Korçë).*

10.1. Me shkresën nr. 321/2 prot., datë 12.02.2024, AKMC ka informuar ndër të tjera se, nën kuadrin e akordimit të ndihmës financiare për banesat e shtetasve të dëmtuar nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore dhe bazuar VKM nr. 206/1998, pas kontrolleve të vazhdueshme arkivore dhe realizimit të procesit inventarizues, nuk disponon të plotë dhe të saktë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga ish- Komuna Velçan për rastin e shtetasit Xh.T pasi mungojnë elementë të tillë si: Vendimi i Këshillit Bashkiak dhe shprehja e pamundësisë financiare për mbulimin e dëmit të shkaktuar, konfirmimi i ligjshmërisë nga Prefektura e Qarkut Korçë, studimi gjeologo-inxhinierik si dhe certifikata familjare në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë. Në mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe pas kontrolleve të vazhdueshme për administrimin e rastit në fjalë, rezulton se shtetasi nuk përfshihet në listën e shtetasve të cilët përfaqësojnë detyrimet e prapambetura financiare dhe si rrjedhojë institucioni ynë, nuk përmban detyrim financiar për rastin e pretenduar. *Procedura administrative e çeljes së fondit financiar për dhënien e ndihmës financiare realizohen në momentin që disponohet dokumentacioni tekniko-ligjor i sakë dhe i plotë, bazuar dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.* Ndodhur në kushtet kur dokumentacioni tekniko-ligjor i shtetasit Xh.T nuk është i plotë, dhe nuk përfshihet në listën e detyrimeve të prapambetura financiare, kemi përcjellë kërkesa të përsëritura njësisë të qeverisjes vendore, me qëllim përcjelljen e dokumentacionit të plotë për rastin në fjalë. Ndërmarrja e veprimeve të tilla, është realizuar pikërisht për të mos cënuar të drejtat e shtetasve dhe realizohet për çdo rast të ngjashëm, bazuar në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për

arkivat”, përkatësisht neni 22, pika 1, arkivat shtetërore vendor administrojnë dhe ruajnë dokumentet e trashëguara, si dhe dokumentet e Arkivave të institucioneve shtetërore vendor dhe të organeve të qeverisjes vendore, që veprojnë brenda njësisë administrativo-territoriale përkatëse. Gjithashtu referuar përcjelljes së fotokopjuar të elementëve të dokumentacionit tekniko-ligjor për rastin e shtetasit Xh.T nga ana jonë kemi informuar se dokumentacioni duhet të përcillet i njehsuar me origjinalin nga njësiti e vetëqeverisjes vendore.

11. Sa sipër me shkresën nr. K3/Xh1-15 prot., datë 27.03.2024, kemi kërkuar nga Këshilli i Qarkut Korçë, të na dërgojë një kopje të njehsuar me origjinalin të dokumentacionit që ka lidhje me praktikën e dëmshtëpërblimit të banesës së shtetasit Xh.T, të dëmtuar nga rrëshqitjet e dheut të vitit 2010, ku të jenë të përfshira edhe:

- Vendimi i Këshillit Bashkiak për shprehjen e pamundësisë financiare për mbulimin e dëmit të shkaktuar, konfirmimi i ligjshmërisë nga Prefektura e Qarkut Korçë, studimi gjeologo-inxhinierik;
- si dhe certifikatën familjare në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë ashtu sikurse është kërkuar nga AKMC-ja (në plotësim të saktë dhe të plotë të dokumentacionit ligjor për shtetasin Xh.T).

11.1. Me shkresën nr. 242/1 prot., datë 11.04.2024, Këshilli i Qarkut Korçë, ndër të tjera ka informuar se, Këshilli i Qarkut Korçë në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi sipas ligjit nr. 8758, datë 26.03.2001, “Për Emergjencat Civile” dhe VKM nr. 206/1998, me shkresën nr. 2335 prot., datë 16.12.2010, ka përcjellë pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, gjithë dokumentacionin origjinal të grumbulluar në lidhje me rastin në fjalë, të dëmtimit të banesës për shkak të rrëshqitjes së dheut të shtetasit Xh.T banues në Velçan, për vijimin e mëtejshëm të procedurës. Dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr. 347/1 prot., datë 31.05.2023, të Këshillit të Qarkut Korçë ka qenë i administruar në kopje të thjeshtë pranë zyrës së punonjësit të emergjencave civile për shtetasin Xh.T dhe është vendosur si dokumentacion mbështetës dhe orientues për rastin në fjalë. Gjithashtu ka theksuar se Këshilli i Qarkut Korçë në zbatim të dispozitave ligjore të kohës që kanë qenë në fuqi, grumbullonte dokumentacionin origjinal dhe e përcillte pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë për vijimin e mëtejshëm të procedurës.

12. Në rrethanat e parashtruara sa sipër, me shkresën nr. K3/Xh1-18 prot., datë 18.06.2024, i kemi kërkuar Prefektit të Qarkut Korçë, të na dërgojë një kopje të njehsuar me origjinalin të dokumentacionit që ka lidhje me praktikën e dëmshtëpërblimit të banesës së shtetasit Xh.T, të dëmtuar nga rrëshqitjet e dheut të vitit 2010, ku të jenë të përfshira edhe vendimi i Këshillit Bashkiak për shprehjen e pamundësisë financiare për mbulimin e dëmit të shkaktuar, konfirmimi i ligjshmërisë nga Prefektura e Qarkut Korçë, studimi gjeologo-inxhinierik; certifikatën familjare në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë ashtu sikurse është kërkuar nga AKMC-ja.

12.1. Me shkresën nr. 571/1 prot., datë 27.06.2024, Prefekti Qarkut Korçë, ndër të tjera, ka informuar se: “ ... sikurse ju kemi bërë me dije në shkresat e dërguara nga ana jonë me nr. 606/1 prot., datë 19.07.2023, “kthim përgjigje” në fatkeqësinë natyrore shkarja e tokës që ka ndodhur në

vitin 2010 në fshatin Velçan e Laktesh të ish- Komunës Velçan, Bashkia Pogradec, kanë pësuar dëme në banesa 29 familje nga fshati Velçan dhe pjesa tjetër nga fshati Laktesh. Paralelisht me masat për normalizimin e situatës është përgatitur edhe dokumentacioni për shlyerjen nga ana financiare të dëmit për familjet, banesat e të cilëve u dëmtuan nga kjo fatkeqësi, mbështetur në VKM nr. 206/1998. Gjithashtu, ka sqaruar faktin se për këtë fatkeqësi janë përgatitur dy dokumente për studim gjeologjik, njëri për fshatin Velçan dhe tjetri për fshatin Laktesh, si dhe dy vendime të përbashkëta të ish këshillit të Komunës Velçan, për çdo fshat. ***E gjithë kjo praktikë me dokumentacionin origjinal për të dy këto fshatra është dërguar në ish Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile për marrjen e shpërblimit financiar, në pamundësi për dhënien e tij nga ish komuna.***

- 12.2 Në vijim shprehet se, kjo konfirmohet edhe në shkresën nr. Extra prot., datë 14.06.2013, të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile “*Njoftim për dhënie fondi financiar njësive të qeverisjes vendore, për t’u shpërndarë në ndihmë të familjeve me banesa të dëmtuara nga fatkeqësi të ndryshme*”, drejtuar Prefektit të Qarkut, ku ishin të përfshira disa familje që kanë pësuar fatkeqësi të ndryshme dhe që nuk janë dëmshpërblyer, në të cilën ndodhej edhe emri i z. Xh.T, i trajtuar më përpara me një vlerë 100,000 lekë.
- 12.3 Nga ana e institucionit të Prefektit janë dërguar shkresa dhe është kërkuar vazhdimisht pranë ish Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile shlyerja e detyrimeve për familjet që kanë pësuar fatkeqësi të ndryshme natyrore.
- 12.4 Në këtë kuadër, përsëri në shkresën nr.3585/15, datë 11.04.2013, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, drejtuar Prefektit të Qarkut, theksohet se Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile disponon dokumentacionin për dhënien e ndihmës financiare këtyre familjeve, duke konfirmuar edhe një herë se dokumentacioni i tyre ishte pranë kësaj drejtorie.
- 12.5. Gjithashtu Institucioni i Prefektit në përgjigje të kërkesës ka dërguar dokumentacionin që aktualisht disponon, *fotokopjen e njehsuar me origjinalin të Vendimit nr. 42, datë 09.12.2010, ish Komunës Velçan “Për miratimin e ndihmës financiare, për fatkeqësi të shkaktuara nga rrëshqitja e tokës, personat, banorë të fshatit Velçan, së bashku me fotokopjen e listës emërore të familjeve të dëmtuara nga fatkeqësi natyrore, shkresën nr.1219 prot., , datë 14.12.2010, të Prefektit të Qarkut Korçë “Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit”, i njehsuar me origjinalin. Ndërsa dokumenti i studimit gjeologjik si dhe certifikata familjare në momentin e ndodhjes së ngjarjes për familjen e z. Xh. Torra nuk është pranë institucionit tonë.*

-II-

Vlerësimi i Avokatit të Popullit, konkluzione dhe rekomandime

13. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është një nga autoritetet e mbrojtjes civile, e cila si një institucion dhe strukturë qendrore ushtron përgjegjësinë e saj në drejtim të planifikimit të fondeve jo vetëm për marrjen e masave parandaluese, por edhe rehabilituese ndaj fatkeqësive.
14. Vlerësojmë se lidhur me rastin në fjalë, veprimtaria administrative e kryer prej AKMC-së nuk ka qenë efikase dhe nuk i është përgjigjur situatës emergjente, si pasojë e së cilës ka rezultuar se

deri më sot akoma nuk është zgjidhur kjo problematikë e ankuesit Xh.T, për shkak të mosakordimit të plotë të fondit për ndihmë financiare, në favor të këtij shtetasi.

15. Konkretisht, ka rezultuar se pas dëmtimit të banesës së shtetasit Xh.T për shkak të rrëshqitjes së dheut, Komuna Velçan, ka ndjekur procedurën dhe ka hartuar dokumentacionin përkatës në përputhje me ligjin e kohës nr. 8756 datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, pikës 3, si dhe të VKM-së VKM nr. 206/1998. Më tej me vendimin nr.42, datë 09.12.2010, Këshilli i Komunës Velçan, për shkak se dëmi ka qenë i madh, ia ka kaluar për shqyrtim Këshillit të Qarkut Korçë, dhënien e ndihmës në lidhje me rastin. Ky i fundit pasi ka kryer të gjitha procedurat ligjore në zbatim të VKM nr. 206/1998, në pamundësi financiare për të përballuar dëmin me shpenzimet e veta, ka përcjellë dokumentacionin përkatës në Prefekturën e Korçës, për zbatimin e procedurave ndjekëse ligjore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe të Përballimit të Emergjencave.
16. Intitucioni i Prefektit ka përgatitur dokumentacionin përkatës për shlyerjen nga ana financiare të dëmit për 29 familje që kanë pësuar dëme dhe e ka dërguar këtë dokumentacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, (DPEC), aktualisht Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.
17. Gjithashtu, ka përgatitur edhe dy dokumente për studim gjeologjik, njëri për fshatin Velçan dhe tjetri për fshatin Laktesh, si dhe dy vendime të përbashkëta të ish këshillit të Komunës Velçan, për çdo fshat. **E gjithë kjo praktikë, me dokumentacionin origjinal për të dy këto fshatra (përfshirë edhe dosjen e z. Xh.T), me shkresën nr.1243/1prot., datë 23.12.2010, është dërguar në ish Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme), për marrjen e shpërblimit financiar, në pamundësi për dhënien e tij nga ish komuna.**
18. Deri më sot nuk është mundësuar akordimi i plotë i ndihmës financiare për këtë shtetas, pasi ai ka përfituar vetëm 100,000 lekë, nga 563,830 lekë që përfaqëson vlerën e plotë të dëmeve të shkaktuara në banesën e tij.
19. Lidhur me qëndrimin e mbajtur nga ana juaj se, nuk dispononi të plotë dhe të saktë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar për rastin e shtetasit Xh.T sqarojmë këtu se, ky është një qëndrim jo korrekt dhe “alogjik”. Sikurse rezultoi nga hetimi administrativ, fakti i përfutimit nga ky shtetas i një pjese të vlerës që i takonte si kompensim financiar për dëmet e shkaktuara në banesën e tij, prezumon faktin se dokumentacioni i tij ka qenë i hartuar dhe i plotësuar në përputhje me ligjin, kjo me argumentin se *procedura administrative e çeljes së fondit financiar për dhënien e ndihmës financiare, bazuar dispozitave ligjore dhe nënligjore, realizohet në momentin që disponohet dokumentacioni tekniko-ligjor i sakë dhe i plotë.* Në kushtet kur kjo panoramë dokumentare ka qenë e plotë, nga ana e autoritetit kompetent shtetëror është vijuar më tej me kompensimin financiar për këtë shtetas edhe pse jo në menyrë të plotë.
20. Edhe sikur në mënyrë hipotetike të pranohet për një çast qëndrimin tuaj të sipërcituar, konstatojmë se, veprimet e ndërmara nga ana juaj nuk i përgjigjen situatës sikundër ju e

parashtroni, pasi nga ana juaj përgjatë gjithë kësaj kohe nuk ka patur asnjë akt administrativ i cili do të përfundonte procedurën administrative lidhur me zgjidhjen e rastit të ankuesit, apo qoftë edhe shkresë “Për kthim dokumentacioni”, për pasaktësi të identifikuara në dokumentacionin që i përket ankuesit, ashtu sikurse ju pretendoni.

21. Në këtë kontekst tërheqim vëmendjen se, edhe nga hetimi i thelluar administrativ bazuar në korrespondencat zyrtare me Institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë ka rezultuar që dokumentacioni tekniko-ligjor i plotë dhe i saktë i hartuar për rastin e shtetasit Xh.T është disponuar nga DPEC, aktualisht AKMC.

20.1 Në këtë aspekt evidentojmë se, kjo konfirmohet edhe nga aktet zyrtare, konkretisht:

- a) Shkresa nr. 3585/15 prot., datë 11.04.2013, “kthim përgjigje”, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, drejtuar Prefektit të Qarkut Korçë nga përmbajtja e së cilës rezulton se, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile disponon dokumentacionin për dëmtimin e 46 banesave në fshatrat Velçan dhe Laktesh të Komunës Velçan, në vitin 2010, nga fenomeni i rrëshqitjes së tokës. Nisur nga fondet e pamjaftueshme në dispozicion të Ministrisë së Punëve të Brendshme për dhënie të ndihmës financiare familjeve të prekura nga fatkeqësi të ndryshme, me shkresën nr 3585/10 prot., datë 20.06.2013, ka çelur fond financiar vetëm për tre familje të Komunës Velçan duke i akorduar një ndihmë financiare në masën 100 000 lekë për secilën prej tyre. (këtu përfshihet edhe familja e ankuesit Torra);
- b) Nga shkresa nr. extra prot., datë 14.06.2013, eë ish Drejtorit të Përgjithshëm të Emergjencave Civile “Njoftim për dhënie fondi financiar njësisive të qeverisjes vendore, për t’u shpërndarë në ndihmë të familjeve me banesa të dëmtuara nga fatkeqësi të ndryshme”, drejtuar Prefektit të Qarkut Korçë, ku gjejmë pasqyrim disa familje që kanë pësuar fatkeqësi të ndryshme dhe që nuk janë dëmshpërblyer, në të cilën ndodhet i përfshirë edhe emri i z. Xh.T;
- c) Nga shkresa nr. 928/1 prot., datë 28.10.2013, “Kujtesë për çelje fondi për familjet e dëmtuara në Komunën Velçan të rrethit Pogradec, si pasojë e shkarjes masive të tokës”, e Prefektit të Qarkut Korçë, drejtuar Drejtorisë së Emergjencave Civile. Nga përmbajtja e kësaj shkrese rezulton ndër të tjera se, Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, në funksion të rolit dhe misionit që ka në qark ka bërë e dije, se me shkresën nr. 1243/1 prot., datë 23.12.2010, ka vënë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile dokumentacionin e plotë për dëmet e shkaktuara nga rrëshqitja e tokës në 46 shtëpitë e banimit të fshatrave Velcan, hartuar sipas VKM nr. 206/1998.

21. Në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

21.1 Bazuar në legjislacionin për dëmshpërblimin financiar për rastet e fatkeqësisë natyrore konkretisht ligji nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, dhe VKM nr. 206/1998 vlerësojmë se, Institucioni i Prefektit ka përmbushur detyrimin ligjor për dërgimin e dokumentacionit të përgatitur nga Njësia Vendore (ish Komunitat, bashkitë dhe Këshilli i Qarkut), në DPEC (në Ministrinë e Punëve të Brendshme), aktualisht AKMC, (pranë

Ministrit së Mbrojtjes), për rastin në fjalë. E gjithë kjo praktikë, me dokumentacionin origjinal për të dy fshatrat Velçan dhe Laktesh (përfshirë edhe dosjen e z. Xh.T), është dërguar në ish-Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (pranë MPB), për marrjen e shpërblimit financiar, në pamundësi për dhënien e tij nga ish- komuna, me shkresën nr.1243/1prot., datë 23.12.2010, të Prefektit të Qarkut Korçë.

- 21.2 Ndërsa vlerësojmë se, në ushtrim të funksioneve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe në përmbushje të përgjegjësi të parashikuara në ligj, gjatë veprimtarisë administrative të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile lidhur me rastin rezulton mosveprim krejtësisht i pajustificuar nga ana juaj në ushtrimin e kompetencave detyruese ligjore, e për pasojë janë kryer veprime ose mosveprime që bien ndesh me frymën e parimeve të Kodit të Procedurës Administrative, e konkretisht konstatojmë se:
22. Është cenuar parimi i ligjshmërisë, i cili parashikohet në nenin 4, të Kodit të Procedurës Administrative, ku parashikohet se: *“Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca”.*
- 22.1 Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë, i cili parashikohet në nenin 13, të Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet se: *“Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie”.*
- 22.2 Parimi i objektivitetit, i cili sanksionohet në nenin 14, të Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet se: *“Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative.”*
- 22.3 Parimi i deburokratizimit dhe i efijencës, i cili parashikohet në nenin 18, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet se: *“Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm”.* Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se veprimtaria administrative e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, nuk është zhvilluar në përputhje me parimet ligjore mbi bazë të të cilit është normuar veprimtaria e këtij organi. Ushtrimi i detyrave sikurse parashikuar në ligj, është i detyrueshëm në këtë situatë në të cilën ndodhet çështja e prezantuar, pasi Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile si një nga organet shtetërore të përcaktuara në ligj është përgjegjëse, ndër të tjera, edhe për riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga fatkeqësia si dhe duhet të bashkërendojë punën jo vetëm për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara por edhe për riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse.
23. Evidentojmë faktin se gjatë hetimit administrativ lidhur me rastin ka rezultuar se ka patur veprime apo mosveprime nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile të cilat nuk kanë qenë në korrelacion me kryerjen e detyrave funksionale dhe në përputhje me kompetencat e këtij

organi, sikurse janë të përcaktuara me ligj, me akt nënligjor, si dhe veprimet administrative të nxjerra në zbatim të tyre, ushtrimi i të cilave është i detyrueshëm¹ për të.

24. Gjatë trajtimit të kësaj çështjeje është me vend të sjellim në vëmendjen tuaj, parimin e përgjegjësisë në veprimtarinë e organeve publike të parashikuar në nenin 15, të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet shprehimisht se: *“Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi”*.
25. Mosveprimi juaj në këtë kuptim, ju vendos në kushtet e parashikuara në ligjin nr. 8510 datë 15.07.1999, *“Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”*, të ndryshuar, (ligji nr.8510/1999), pasi realisht ankuesit i është shkaktuar një dëm pasuror, në kushtet e trajtimit jo në përputhje me parashikimet ligjore të kësaj çështjeje. Në kuptim të përgjegjësisë jashtëkontraktore, si një detyrim i organeve të administratës shtetërore, për të shpërblyer dëmin që i është shkaktuar interesave të ankuesit si person privat, në ushtrim e sipër të funksioneve tuaja publike, rasti në fjalë parashikohet në nenin 3, paragrafi “a”, të ligjit nr.8510/1999, ku parashikohet se: *“Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë private, në rastet që vijnë, ... -Kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme”*. Kujtojmë se, organet e administratës shtetërore janë të detyruara që qytetarëve t’u sigurojnë, realizim të drejtë dhe efikas të të drejtave, lirive kushtetuese e ligjore, si dhe interesave të tyre të ligjshme gjatë një procedure administrative. Të drejta dhe interesa këto të vërtetuara dhe të njohura me ligj. Në ushtrimin e veprimtarisë tuaj duhet të udhëhiqeni nga parimi i ligjshmërisë dhe përgjegjshmërisë në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara. Kjo pasi çdo organ administrativ duhet ta mbështesë veprimtarinë e tij administrative tek parashikimet ligjore e nënligjore, si dhe të përgjigjet për veprimet e tij tek autoritete të tjerë administrativë, legjislativë ose juridikë. Përgjegjshmëri do të thotë gjithashtu që asnjë autoritet nuk duhet të përjashtohet nga hetimi, duke përfshirë hetim nga gjykatat, ankim tek një organ administrativ më i lartë, investigim nga Avokati i Popullit, inspektim nga një bord ose komision special dhe hetim nga një komision parlamentar. Përgjegjshmëria është një instrument që tregon nëse respektohen parimet e ligjshmërisë, të qenit i hapur, parimi i transparencës, parimi i paanësisë dhe barazisë para ligjit. Përgjegjshmëria është esenciale për të siguruar vlera si efica, efektiviteti, besueshmëria dhe parashikueshmëria e administratës publike.
- 25.1 Mbi këtë bazë dhe në përputhje me parashikimet e bëra në nenet 5 dhe 8, të ligjit nr.8510/1999, ju si organ publik, duhet tashmë që të filloni një procedurë administrative për njohjen e dëmit që i keni shkaktuar z. Xh.T, duke marrë për bazë edhe dispozitat respektive të Kodit Civil, për shkaktimin e dëmit, si dhe nxjerrjen e përgjegjësisë përkatëse.
26. Në vijim të analizës sonë, theksojmë se, në kuadër të bashkëpunimit gjatë procesit të zhvillimit të hetimit administrativ, evidentojmë faktin se gjatë komunikimit institucional me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, ka rezultuar se edhe pse janë kthyer përgjigje në aspektin formal lidhur me kërkesat për shpjegime apo informacion të dërguara nga Avokati i Popullit, në vlerësimin tonë ato nuk mund të konsiderohen të tilla në aspektin substancial.

¹ Neni 22/2 i Kodit të Procedurës Administrative.

Kështu në përgjigjet e dhëna nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është mjaftuar vetëm në përmendjen e akteve të mbajtura prej Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, si dhe referencat gjenerike ligjore që rregullojnë veprimtarinë e këtij organi. Gjithashtu, nuk i keni kthyer përgjigje në mënyrë të përsëritur, çështjeve të specifikuara për informacion nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të cilat kanë rëndësi për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

- 26.1 Duke e konsideruar refuzues qëndrimin e mbajtur prej Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në më shumë se në një rast, çmohet se ky qëndrim ka cenuar një ndër parimet më të rëndësishme, parimin e bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike.
- 26.2. Parimi i bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike, është sanksionuar si në parimet e Kodit të Proedurës Administrative, ashtu edhe në ligjin nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore". Neni 3, i këtij ligji parashikon se: *1. Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucioneve të pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin".*

Në këtë kontekst, sqarojmë se bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Mungesa e informacionit dhe e dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme, apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu minon besimin e qytetarëve tek shteti i së drejtës dhe administrata shtetërore ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel evropian por edhe të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

27. Në këtë këndvështrim, duam t'iu kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Europian, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit: *"Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të"*.
28. Referuar rastit në hetim, nuk rezulton që Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile si një organ administrativ të ketë zbatuar detyrimet ligjore në kuadër të sigurimit të një procesi të rregullt ligjor.

- 28.1 Detyrimi për një proces të rregullt ligjor buron edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë, si Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (neni 6 i saj), i cili kërkon detyrimisht aplikim rigoroz nga instrumentat e brendshëm të një shteti.
- 28.2 Në respektim të këtij parashikimi, e drejta për një proces të rregullt ligjor është ngritur në nivel Kushtetues. Konkretisht neni 42, pika 1, e Kushtetutës, parashikon se: *“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”*, ndërsa neni 15, pika 2, e Kushtetutës parashikon se: *“Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”*.
29. Në analizë të parashikimeve Kushtetuese rezulton se ankuesi, për shkaqe të pavarura nga ai, nuk ka marrë një vendim përfundimtar në një procedurë administrative, në një kohë që ka respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni përkatës, e për rrjedhojë ai nuk i gëzon të drejtat që i garanton legjislacioni në fuqi. Institucioni ynë vlerëson se vonesa në trajtimin e praktikës së shtetasit Xh.T, kufizon liritë dhe të drejtat e tij të garantuara nga Kushtetuta dhe ligji, e më konkretisht, të drejtën e pronësisë.
30. Një tjetër çështje që sjellim në vëmendjen Tuaj për shkak të zgjatjes së procedurës administrative është cenimi i parimit të sigurisë juridike.
- 30.1 Siguria juridike nënkupton, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Organet e administratës nuk mund të përkeqësojnë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojnë të drejtat e fituara ose të shpërfillin interesat legjitime të tyre.
- 30.2 Besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm jo vetëm për t'u mbrojtur nga normat dhe parimet kushtetuese por edhe nga veprimtaria e administratës gjatë veprimtarisë së saj, e cila duhet të garantojë ligjshmërinë e veprimeve që shteti kryen me qytetarët e tij, sigurinë juridike se qytetari është objekt i veprimeve të ligjshme dhe se institucionet shtetërore do i garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të tij.
- 30.3 Shkelja e të drejtave të mësipërme, sjell në marrëdhënie me shtetasit një sërë problematikash, duke filluar që nga humbja e besimit të qytetarëve tek organet e administratës publike, e deri tek rreziku i përballjes së organeve të administratës me padi civile për dëm jashtëkontrator, që mund t'i jetë shkaktuar shtetasve, nga shkelja e të drejtave të sipërpërmendura.
- 30.4 Organet e administratës publike duhet të bëjnë përpjekjet maksimale për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor e në përputhje me nenin 6/1 të KEDNJ-së. Kjo procedurë, nuk është përfunduar në mënyrë të rregullt dhe nga një hetim i thelluar administrativ, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile pa asnjë shkak të justifikuar ligjërisht, edhe pse është kërkuar vazhdimisht përfundimi i saj.
- 30.5 Sa sipër, ky institucion gjendet në shkelje të procesit të rregullt ligjor, në zhvillimin e procesit administrativ, në kushtet që edhe pse kanë kaluar disa vite akoma nuk është adresuar dhe trajtuar në mënyrë përfundimtare rasti i ankuesit, edhe pse nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile në muajin qershor të vitit 2013, atij i është akorduar vetëm një pjesë në masën 100 000 lekë, nga vlera totale e ndihmës financiare që i takon. Por që nga ajo kohë e deri më sot nuk është

ndërmarrë më asnjë veprim tjetër nga ana juaj në përmbushje të këtij detyrimi, e për pasojë jemi në kushtet kur nuk është mundur ende akordimi i plotë i ndihmës financiare për ankuesin Xh.T.

31. Bazuar në nenin 63, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, si dhe nenin 21, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimeve ,Avokati i Popullit kryen këto veprime ..., b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,c) Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*;

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për akordimin e vlerës së pashlyer të ndihmës financiare për shtetasin Xh.T banesa e të cilit është dëmtuar nga fatkeqësi natyrore, konkretisht si pasojë e rrëshqitjes masive të tokës në fshatin Velçan, Njësia Administrative Velçan, Pogradec.
2. Marrjen e masave lidhur me nxjerjen e përgjegjësive dhe evidentimin e personave që kanë çuar në cenimin e së drejtës së ankuesit duke mos vijuar procedurën administrative të çeljes së fondeve për dhënien e plotë të ndihmës financiare për shtetasin Xh.T, lidhur me dëmtimin që banesa e tij ka pësuar nga rrëshqitja e dheut.
3. Marrjen e masave administrative dhe ligjore për mospërsëritjen e situatave të tilla në të ardhmen, pra të mosveprimit të institucionit tuaj, duke mos respektuar procedurat ligjore dhe të drejtat e shtetasve.
4. Shpërblimin e plotë të dëmit të shkaktuar ankuesit sipas parashikimeve e vlerës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
5. Marrjen e masave përkatëse për të adresuar mungesën e komunikimit korrekt me institucionin e Avokatit të Popullit sa i përket kërkesave për informacion, në lidhje me të cilat përgjigjet kanë rezultuar me përmbajtje të paplota në disa aspekte.

Në zbatim të nenit 22, të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, “ Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi lutemi të na vini në dijeni mbi qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi si dhe masat e marra për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Bashkëlidhur ju dërgojmë kopje të:

- shkresës nr. Extra prot., datë 14.06.2013, të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile
“Njoftim për dhënie fondi financiar njëjësive të qeverisjes vendore, për t’u shpërndarë në ndihmë të

- familjeve me banesa të dëmtuara nga fatkeqësi të ndryshme”, drejtuar Prefektit të Qarkut Korçë” (1 faqe)*
- shkresës nr. 3585/15 prot., datë 11.04.2013, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme (1 faqe).
 - shkresës nr. 618/1 prot., datë 17.6.2013, të Prefektit të Qarkut Korçë (1 faqe).
 - shkresës nr. 928/1 prot., datë 28.10.2013, të Prefektit të Qarkut Korçë, drejtuar Drejtorisë së Emergjencave Civile. (1 faqe).
 - vendimit nr. 42, datë 09.12.2010, i ish Komunës Velçan “Për miratimin e ndihmës financiare për fatkeqësitë shkaktuara nga rrëshqitja e tokës, personat, banorë të fshatit Velçan, së bashku me fotokopjen e listës emërore të familjeve të dëmtuara nga fatkeqësi natyrore. (2 faqe).
 - shkresës nr.1219, datë 14.12.2010, të Prefektit të Qarkut Korçë “Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit”, (1 faqe).

KOMISIONERE

ERINDA MELI

d.v